



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



“Klan Kosova” Sh.p.k.
Drejtor – Baton Haxhiu
OSHMA Klan Kosova
Zona Industriale
(ish – Fabrika e Amortizatorëve)
Prishtinë

Ref: 1705/418/LIC/ni

VENDIM

për miratimin e kërkesës për ndryshimin e skemës programore të Ofruesit të Shërbimeve
Mediale Audiovizuale Klan Kosova (Parashtruesi i kërkesës),
me seli në Prishtinë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Medive (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Klan Kosova është të Ofruesit të Shërbimeve Mediale Audiovizuale, i cili është i licencuar nga Komisioni i Pavarur i Mediave për transmetimin e programeve televizive përmes operatorëve të shpërndarjes, me seli në Prishtinë.
3. Më datën 21 tetor 2016, Klan Kosova ka parashtruar një kërkesë, me anë të së cilës ka kërkuar miratimin e KPMrasti I mbyllur-së për ndryshimin e skemës programore.
4. Më datën 2 nëntor 2016, KPM, përmes e-maili i është drejtuar Parashtruesit të Kërkesës, përmes së cilit ka kërkuar informacione shtesë lidhur me ndryshimin e segmenteve programore, si dhe e ka njoftuar palën lidhur me obligimin e pagesës së tarifës administrative në vlerë prej njëqind (100) eurove, për ndryshime në licencë.

5. Gjitashtu, zyrtarët e KPM-së, kanë janë takuar me përfaqësuesit e Klanë Kosova, ku është kërkuar plotësimi i kërkesës me informacionet dhe dokumentacionet e nevojshme.
6. Me datën 9 gusht 2017, Parashtruesi i Kërkesës, përmes e-maili ka dërguar të dhënat e nevojshme lidhur me plotësimin e kërkesës për ndryshimin e skemës programore.

Arsyetimi

7. Neni 14, paragrafi 1, i Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së përcakton:
“I Licencuari duhet që në transmetimet e veta, si një nga kushtet e Licencës, t’i përmbahet formatit dhe strukturës së përgjithshme të programit në bazë të të cilit i është dhënë Licenca dhe e drejta e përdorimit të spektrit të frekuencës. Dështimi për të vepruar në pajtueshmëri me këtë mund të rezultojë deri në anulimin e Licencës”.
8. Ndërsa Neni 14, paragrafi 2, i Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së përcakton:
“I Licencuari obligohet që paraprakisht ta njoftojë me shkrim KPM-në lidhur me propozimin për ndryshime të mëdha të tipit ose burimit të programeve të dhëna në Pjesën 3 të Licencës ose të propozimit të heqjes së një përbërësi të formatit të licencuar. KPM-ja do ta njoftojë të Licencuarin me kohë, në rast se këto ndryshime të propozuara përputhen me interesat publike në bazë të të cilave i është dhënë Licenca, dhe nëse ato janë të tilla, do të ndryshojë Pjesën 3 të licencës së transmetimit në përputhje me kërkesën e të licencuarit.”
9. Ndërsa Neni 2, i Pjesës së tretë të licencës së KPM-së - Formati i Programit, thekson:
“Nga i Licencuari kërkohet që të njoftojë paraprakisht KPM-në për ndryshime të rëndësishme të cilat ai i propozon t’i bëjë në formatin e programit siç është përcaktuar në Pjesën 3 të Licencës. KPM-ja do ta njoftojë me kohë të Licencuarin nëse këto ndryshime të propozuara janë në përputhje me interesat publike në bazë të të cilave i është dhënë Licenca e parë, dhe nëse ato janë të tilla, KPM do të ndryshojë Pjesën 3 të Licencës në përputhje me kërkesat e të licencuarit.”
10. Komisioni konstaton se, kërkesa për ndryshimin e skemës programore është e kompletuar. Parashtruesi i Kërkesës ka ofruar informacione të qarta lidhur me ndryshimet e segmenteve programore si dhe ka kryer pagesën e tarifës administrative për ndryshime në licencë në vlerë prej njëqind (100) eurove, e përcaktuar me Rregulloren KPM - 2017/03.
11. Komisioni vleronë se, ndryshimet e propozuara të skemës programore të Parashtruesit të Kërkesës, janë ndryshime në interes të publikut.
12. Komisioni konsideron që kërkesa e parashtruar është e kompletuar në pajtim Procedurat e KPM-së për ndryshim të skemës programore, dhe si e tillë i plotëson kriteret për miratim.

Rekomandim

13. Komisioni në takimin e tij të mbajtur më datën 22 shtator 2017, merr vendim për miratimin e kërkesës për ndryshim të skemës programore të OSHMA Klan Kosova.

Lëshimi i Vendimit

14. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.


Adnan MEROVCI
Kryetar
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



26.09.2017

datë